



*Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Nr: 018-246
Datë: 23.12.2024

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 34/18 nëntor 2022), nenit 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 08.L/-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (Gazeta Zyrtare Nr. 17/ 13 gusht 2023), në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.7, nenit 8 si dhe shtojcës 7 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 09.08.2023 dhe Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XXK të nënshkruar me datën 28 qershor 2024 nga Republika e Kosovës dhe Banka Botërore nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e Udhëzuesit mbi funksionimin e Programit të Kuponëve

1. Miratohet udhëzuesi mbi funksionimin e Programit të Kuponëve.
2. Programi i Kuponëve është nën-komponent i Projektit “Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës” të Bankës Botërore (BB), i cili synon të përmirësojë cilësinë dhe qasjen e barabartë në shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme në Kosovë.
3. Obligohet Departamenti i Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e tjera kompetente të fillojnë zbatimin e këtij Udhëzuesi.
4. Shtojca nr. 1 e këtij vendimi është Udhëzuesi mbi funksionimin e Programit të Kuponëve.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe kërkesës së miratuar me datën 16.12.2024 për hartimin e vendimit për zbatimin e Udhëzuesit mbi funksionimin e Programit të Kuponëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit;
2. Zyrës së SP;
3. Arkivit.

Arbërie Nagavci

Ministre/MASHTI



Udhëzues mbi funksionimin e Programit të Kuponave

Viti 2024

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
1. Programi i Kuponave	5
2. Institucioni zbatues	6
3. Identifikimi i fëmijëve përfitues të programit dhe procedura e aplikimit.....	7
4. Identifikimi dhe roli i institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme.....	9
5. Transporti.....	11
6. Mekanizmi i ankesës.....	13
7. Shuma e rimbursimit të kuponave	15
8. Kontrollimi i pagesave, raportimi dhe auditimi.....	15
9. Monitorimi i Programit të Kuponave.....	17
10. Përfundimi i ciklit të edukimit nga fëmijët.....	19
11. Plani i komunikimit.....	19
12. Faza e pilotimit	21
Shtojcat	23
Shtojca 1. Regjistrimi i Institucioneve Parashkollore Private për Programin e Kuponave përmes e-Kosova	23
Shtojca 2. Raportimi i IEFH Private për vijueshmërinë e përfituesve përmes e-Kosova (duhet të jetë i hapur gjithnjë dhe të dhënat të ruhen në formë të databazës).....	24
Shtojca 3. Aplikimi i familjeve për përfitim nga Programi i Kuponave – i hapur për të gjithë familjet të cilët kanë fëmijë të moshës 2 vjet e 6 muaj deri në 4 vjet e 6 muaj dhe që janë përfituese nga Skema e Asistencës Sociale, përmes e-Kosova.....	24
Shtojca 4. Dokumenti i Kuponit	25
Shtojca 5. Mekanizmi i ankesës dhe komenteve	26
Formulari 5.A Mekanizmi i ankesave përmes e-Kosova	26
Formulari 5. B Ankesa në lidhje me IKFH-të dhe aktivitetet e programit.....	27
Shtojca 6. Formulari i verifikimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit.....	33
Shtojca 7. Riaplikimi për prindërit apo kujdestarët ligjorë për vazhdimin e kuponit përmes e-Kosova.	33

Shkurtesat

Banka Botërore (BB)

Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA)

Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme (EKFH)

Institucion i Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH)

Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave (KVAPK)

Kontrata e Bazuar në Performancë (KBP)

Manuali i Operacioneve të Projektit (POM)

Menaxhimi Financiar (MF)

Mekanizmi i Pavarur i Verifikimit (MPV)

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

Menaxhimi Financiar Publik (MFP)

Njësia e Implementimit të Projektit (NJIP)

Pasqyra Financiare e Projektit (PFP)

Partneriteti i Mësimi të Hershëm (PMH)

Pyetjet më të Shpeshta (PSH)

Raporti i Ndërmjetëm Financiar i Paaudituar (RNFP)

Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK)

Skema e Asistencës Sociale (SAS)

Specialisti/ja i/e Menaxhimit Financiar (SMF)

1. Programi i Kuponave

Pjesëmarrja e fëmijëve në shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme (EKFH) u ofron fëmijëve mundësi për zhvillim kognitiv, social, emocional dhe fizik, duke përmirësuar socializimin si dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Ky edukim krijon një bazë të fortë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për sukses akademik.¹ Përveç kësaj, përmes rritjes së qasjes në arsim dhe mundësive profesionale, edukimi sjell përfitime sociale duke u mundësuar prindërve që të marrin pjesë në tregun e punës, duke përmirësuar stabilitetin ekonomik të familjes dhe duke kontribuar në barazinë gjinore dhe gjithëpërfshirjen shoqërore.²

Megjithatë, në Kosovë, disponueshmëria e kujdesit dhe edukimit cilësor për fëmijët e vegjël është e kufizuar dhe shpesh konsiderohet e kushtueshme për familjen, gjë që çon në një shkallë të ulët të regjistrimit në programe të edukimit të hershëm.³ Sipas të dhënave të vitit 2023, vetëm 2,3% e fëmijëve të moshave 3 deri në 5 vjeç në kuadër të Skemës së Asistencës Sociale (SAS) ishin të regjistruar në institucione parashkollore.⁴

Marrë parasysh rëndësinë e EKFH, Programi i Kuponave ka për qëllim të përmirësojë qasjen e fëmijëve 3-5 vjeçar në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme nga familjet të cilat janë të regjistruara në SAS pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Pra, përfitues direkt të Programit të Kuponave janë familjet e regjistruara në SAS me të paktën një fëmijë nga mosha 3 deri në 5 vjeç.

Programi është nën-komponent i Projektit “Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës” të Bankës Botërore (BB), i cili synon të përmirësojë cilësinë dhe qasjen e barabartë në shërbimet e EKFH në Kosovë. Programi financohet nga Granti i Partneritetit të Mësimit të Hershëm (PMH) i BB-së në shumën prej 1.8 milion euro (2 milion dollarë), dhe është i bazuar në performancën e institucioneve zbatuese.

Programi i Kuponave zgjat nga muaji dhjetor 2024 deri në qershor 2027.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është që të ofrojë udhëzime për palët e përfshira në zbatimin e Programit të Kuponave, për të kryer detyrat e tyre në mënyrë korrekte dhe efikase. Udhëzuesi rregullon në përgjithësi ecurinë e Programit të Kuponave dhe në mënyrë specifike, kriteret targetuese, mekanizmin e transferit të fondeve, procedurat për përzgjedhjen e përfituesve dhe institucioneve parashkollore private, institucionet parashkollore në partneritet publiko-privat dhe format e tjera

¹ Banka Botërore, publikim i ardhshëm.

² Banka Botërore, Një analizë e situatës së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë, në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/896121631867828915/pdf/A-Situational-Analysis-of-Early-Childhood-Development-ECD-Services-in-Kosovo.pdf>

³ Banka Botërore, publikim i ardhshëm.

⁴ Të dhënat nga MASHTI.

alternative të organizimit në pajtim me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu rregullon transportin e fëmijëve, kërkesat për kontrollin e pagesave, raportimin, monitorimin dhe auditimin.

Ky program targeton si ofrues të shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme si; institucionet parashkollore private, institucionet parashkollore në partneritet publiko-privat dhe format e tjera alternative të organizimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.⁵ Ky Udhëzues nuk përfshin institucionet parashkollore publike dhe format alternative të cilat financohen plotësisht nga fondet publike dhe nuk aplikohet në raport me to.

Përgjatë Udhëzuesit është përdorur kryesisht përkufizimi “*institucion i edukimit në fëmijërinë e hershme (IEFH)*” në pajtim me legjislacionin në fuqi, mirëpo referimi në tekst i institucioneve parashkollore, brenda këtij Udhëzuesi vlen edhe për të gjitha format e tjera të organizimit të lartcekura, përpos kur shprehimisht ceket ndryshe.

Udhëzuesi do të përshtatet sipas nevojës, me sqarime shtesë të inkuorporuara bazuar në njohuritë e fituara gjatë zbatimit dhe çdo sfidë apo çështje që lind gjatë gjithë programit.

2. Institucioni zbatues

Granti “Programi i Kuponave” do të zbatohet përmes Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

MASHTI do të sigurojë personel adekuat të përbërë nga profesionistët e nevojshëm për t'i përmbushur objektivat e programit gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit. MASHTI do të angazhojë një koordinator/e të Programit të Kuponave dhe një Mekanizëm të Pavarur të Verifikimit (MPV) për të ndihmuar në zbatimin dhe në verifikimin e arritjes së rezultateve të Programit të Kuponave.

Bazuar në Ligjin 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, MASHTI me vendim të posaçëm cakton kushtet dhe kriteret për ndarjen e kuponave për fëmijë nga familjet që përfitojnë nga SAS. Në kuadër të këtij vendimi, MASHTI do të hapë thirrjen për aplikim në Programin e Kuponave si dhe themelon a) Komisionin për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave (KVAPK), dhe b) publikon, mirëmban dhe e përdor një mekanizëm të qasshëm të ankesave gjatë gjithë kohës.

MASHTI njëashtu publikon thirrjen për përzgjedhjen e MPV-së për të verifikuar arritjen e objektivave vjetore të Kontratës së Bazuar në Performancë (KBP), për të konfirmuar shpërndarjen e kuponëve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në përputhje me udhëzimet e dakorduara.

⁵Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, neni 12 dhe 13.

MASHTI do të zhvillojë sesione informuese për IEFH-të për ti informuar lidhur me procedurat e pjesëmarrjes në program.

IEFH-të do t'i raportojnë MASHTI-t lidhur me a) vijueshmërinë e përfituesve dhe b) nëse fëmija përfitues, nuk ka ndjekur edukimin dhe familja nuk ka njoftuar për arsyen e mungesës për më shumë se 2 javë. Koordinator i Programit nga MASHTI dhe IEFH do të jenë përgjegjëse për kontaktimin e prindërve apo kujdestarëve ligjorë për të kërkuar informacion në lidhje me mungesën e fëmijës.

3. Identifikimi i fëmijëve përfitues të programit dhe procedura e aplikimit

Të gjitha familjet e regjistruara në SAS, pranë MFPT-së, të cilat kanë së paku 1 fëmijë të moshës 3 deri në 5 vjeç kanë të drejtë të aplikojnë në Programin e Kuponave.

MASHTI nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Kuponave, do të mbajë dhe përditësoj listën e përfituesve që janë përzgjedhur për të qenë pjesë e Programit.

3.1 Procedura e aplikimit për përfituesit

Formulari i aplikimit është i disponueshëm për të gjitha familjet përfituese të skemës së ndihmës sociale duke e bashkangjitur kartelën e asistencës sociale në procedurë të aplikimit.

Aplikimet dhe riaplikimet janë të disponueshme 1 herë në vit, në afat prej 21 ditësh, për familjet të cilat i përmbushin kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzues dhe dorëzohen vetëm përmes e-Kosova (Shtojca 3).

Aplikuesit mund të jenë prindërit apo kujdestarët ligjorë të fëmijëve. Ata mund t'i zgjedhin institucionet private brenda komunës së tyre të banimit si dhe ta paraqesin kërkesën për transportin e fëmijës përmes formularit të aplikimit në e-Kosova. Zgjedhja e institucionit do të jetë subjekt i disponueshmërisë së vendeve të deklaruara nga institucioni përmes e-Kosova dhe vendimit të komisionit vlerësues.

Familjet, fëmijët e të cilëve kanë përfituar nga Programi i Kuponave mund të riaplikojnë vitin pasues me qëllim të vazhdimit të përfitimit nga programi. Familja riaplikon duke konfirmuar dokumentacionin përkatës nëpërmjet e-Kosova dhe mbështetja vazhdohet automatikisht për sa kohë që familja vazhdon të jetë përfituese e SAS (Shtojca 6).

Në momentin e aplikimit përmes e-Kosova, MASHTI do të njoftohet lidhur me dokumentacionin e përcjellë të aplikuesit.

3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fëmijëve

Për t'u kualifikuar si përfitues nga Programi i Kuponave, aplikuesit duhet ti plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Familjet e tyre duhet të jenë të regjistruara në SAS si përfitues;
2. Të kenë të paktën një fëmijë të moshës nga 3 deri në 5 vjeç në kohën e regjistrimit në institucionin parashkollor;
3. Fëmija duhet të ketë vendbanimin në komunën ku aplikon për ta vijuar edukimin.

Familja e cila i përmbush kriteret e lartcekura mund të aplikoj për më shumë se një fëmijë.

Ndonëse programi synon të akomodojë fëmijët me aftësi të kufizuara, ky akomodim do të varet nga kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IEFH-ve.

Mosha e fëmijës llogaritet nga data e ofrimit të shërbimit në institucionin parashkollor, jo nga data e aplikimit në Program. Rrjedhimisht prindi apo kujdestari ligjor mund të aplikoj edhe para se fëmija të ketë mbushur moshën 3 vjeç apo 5 vjeç, duke filluar 2 vjet e 6 muaj deri në moshën 4 vjet e 6 muaj. Me kusht që vijimi në institucion parashkollor ta nis në moshën 3 vjeçare dhe ta përfundoj kur fëmija fillon edukimin e detyrueshëm parafillor pas moshës 5 vjeçare.

Të gjithë fëmijët të cilët i plotësojnë kriteret e lartpërmendura do t'i nënshtrohen përzgjedhjes në mënyrë të automatizuar të rastësishme. Formula përmes së cilës do të përzgjidhen përfituesit e programit aplikohet bazuar në:

$$n_m \sim N_m / N$$

- n_m është madhësia e mostrës në komunën "m";
 N_m është popullsia totale e synuar nga komuna "m";
 n është madhësia totale e kampionit;
 N është popullsia totale e synuar.

3.3 Përzgjedhja e përfituesve nga Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave

Para fillimit të Programit, MASHTI themelon Komisionin për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave. Komisioni do të përbëhet nga pesë anëtarë të përzgjedhur nga MASHTI, me mandat një vjeçar.

Përgjegjësitë e Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave (KVAPK) janë:

1. Verifikon saktësinë e dokumenteve dhe të dhënave të ngarkuara nga aplikuesit në e-Kosova, për t'u siguruar se fëmijët i përmbushin kriteret e përcaktuara me Udhëzues dhe përshtaten me IEFH-të përkatëse;

2. Vlerëson nëse familjet dhe IEFH-të përmbushin kërkesat për përfitimin e Kuponit të Transportit dhe cakton shumën e kuponit në pajtim me seksionin 5 të këtij Udhëzuesi;
3. Vlerëson nëse IEFH-të plotësojnë kriteret për të akomoduar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sa mund të akomodojnë sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
4. Harton vendimin me listën e përfituesve të përzgjedhur me IEFH dhe i njofton ata nëpërmjet e-Kosova;
5. Pas procesit të përzgjedhjes dorëzon një raport gjithëpërfshirës në lidhje me procesin e plotë të përzgjedhjes dhe pranimi të fëmijëve.

KVAPK do të përpilojë listën përfundimtare të përfituesve brenda 15 ditëve pas mbylljes së procesit të aplikimit. Vendimi do të publikohet në kanalet zyrtare të MASHTI-t dhe do të ndahet me të gjithë aplikantët përmes e-Kosova (Shtojca 4a). Nëse ka një numër të konsiderueshëm aplikimesh, ky afat mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.

Përfituesit do të marrin një konfirmim për përzgjedhjen e tyre në Programin e Kuponave së bashku me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në e-Kosova (Shtojca 4b). Kuponi nuk mund të transferohet te një person tjetër dhe nuk mund të shitet.

3.3 Regjistrimi i fëmijëve në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme

Pas pranimi të konfirmimit pozitiv nga KVAP përmes e-Kosova, përfituesit duhet të paraqiten brenda 5 ditëve në IEFH për ta konfirmuar dokumentacionin e tyre.

Zyrtari i regjistrimit nga IEFH do të verifikojë të dhënat e fëmijës:

- a) të dhënat e imunizimit/vaksinimit, alergjitë ose nevoja të veçanta ushqimore dhe shëndetësore, përfshirë edhe dëshminë nga mjeku për gjendjen e përgjithshme të fëmijës; dhe
- b) informacionin e kontaktit të prindit/kujdestarit ligjorë.

Të dhënat e fëmijëve përfitues nga Programi i Kuponave do të regjistrohen bazuar në Ligjin Nr. 08/L-153 për Edukim në Fëmijërinë e Hershme dhe legjislacionin në fuqi.

4. Identifikimi dhe roli i institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme

4.1 Regjistrimi dhe verifikimi i institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme në Programin e Kuponave

Të gjitha IEFH të licensuara duhet të regjistrohen përmes sistemit të e-Kosova duke e shprehur interesin e tyre për pjesëmarrje në program (Shtojca 1).

Aplikimi për regjistrimin e Institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme hapet 1 herë në vit dhe mbetet i hapur për një periudhë prej 15 ditësh. Regjistrimi i tyre do të vërtetohet brenda një periudhe prej 15 ditëve nëpërmjet departamentit përgjegjës për licensimin e IEFH-ve, Divizionit për Arsim Parauniversitar Privat të MASHTI-t.

IEFH-të pjesëmarrëse do të informohen nëpërmjet MASHTI-t lidhur me përgjegjësitë e tyre dhe mënyrën e zbatimit të Programit të Kuponave.

IEFH-të pjesëmarrëse në Programin e Kuponave do t'i nënshtrohen procedurës së monitorimit dhe vlerësimit nga a) MASHTI b) Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), dhe d) MPV i përzgjedhur nga MASHTI.

4.2 Raportimi i IEFH në MASHT

Të gjitha raportimet e IEFH realizohen nëpërmjet vegëzës së e-Kosova (Shtojca 2). Raportimet dërgohen në baza mujore, 5 ditë para përfundimit të muajit.

1. MASHTI dërgon rikujtimet nëpërmjet e-Kosova për raportim 10 ditë para përfundimit të çdo muaji.
 - 1.1. Nëse institucioni pjesëmarrës nuk ka raportuar deri në 3 ditë pas përfundimit të afatit. MASHTI dërgon vërejtjen dhe kërkon që raporti të dorëzohet brenda afatit shtesë prej 3 ditëve.
 - 1.2 Nëse institucioni pjesëmarrës dështon të dërgoj raportin edhe pas vërejtjes, atëherë MASHTI vendos a) bartjen e përfituesve në një institucion tjetër të afërt dhe b) përjashton institucionin nga programi.
 - 1.3 Nëse IEFH e humbë licensën apo nuk i vazhdohet licensimi, atëherë MASHTI vendosë a) bartjen e përfituesve në një institucion tjetër të afërt dhe b) përjashton institucionin nga programi.
2. IEFH janë të detyruara të raportojnë në baza mujore, nëpërmjet e-Kosova, për vijueshmërinë e fëmijës në kopsht.
 - 2.1. Raportimi i mungesës përpilohet kur përfituesi, brenda një periudhe 2 javore, nuk vijon institucionin parashkollor pa ndonjë arsytim të pranueshëm paraprak.

Nëse fëmija nuk vijon edukimin për një periudhë prej 2 javë, MASHTI dhe IEFH do t'i ndjekin hapat si në vijim:

1. Kontaktimin e familjes përmes telefonit ose adresës postare për të kërkuar informacion në lidhje me mungesën e fëmijës.

2. Nëse familja nuk e dërgon fëmijën në IEFH edhe pas kontaktimit, atëherë MASHTI në afat prej 5 ditësh merr vendim për ndërprerjen e mbështetjes nëpërmjet Programit të Kuponave.

5. Transporti

Programi i Kuponave do të mbulojë koston e transportit për fëmijët të cilët nuk janë në gjendje të udhëtojnë të sigurt të shoqëruar nga prindërit ose kujdestari i tyre ligjor, distanca e të cilëve është së paku 4 kilometra për në institucionin më të afërt parashkollor.

Përfshihet edhe në rastet kur fëmijët banojnë më pak se 4 kilometra larg institucionit, prindërit/kujdestari ligjor mund të aplikojnë për transport nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të të cilat shfaqin nevojën për transport.

Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave vlerëson shkaqet e arsyeshme për transport sipas nevojës si dhe përmbushjen e kriterit të distancës rrugore.

Në rastet kur IEFH ofron transport, atëherë prindërit dhe kujdestarët ligjorë përdorin transportin e organizuar nga institucioni.

Në rastet kur transporti sigurohet dhe rregullohet nga IEFH përkatës, atëherë institucioni detyrohet të organizojë një formë të përshtatshme transporti i cili i përmbush kriteret si në vijim:

- 1) Forma e transportit duhet t'i mundësojë fëmijës të udhëtojë me siguri dhe rehati të arsyeshme, si dhe një shoqërues/e i/e rritur duhet t'i shoqërojë fëmijët në çdo udhëtim. Ky person do të jetë përgjegjës për t'u siguruar që fëmijët të ulen siç duhet, të mbikëqyrë sjelljen e tyre dhe t'i ndihmojë ata gjatë hyrjes dhe daljes. Prindërit gjithashtu mund ta shoqërojnë fëmijën e tyre në udhëtimet e para derisa fëmija të ndihet rehat. Si një udhëzues i përgjithshëm, koha maksimale e udhëtimit për fëmijën nuk duhet të kalojë 30 minuta në çdo drejtim.
- 2) Të gjitha automjetet duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të rregullta teknike për t'u siguruar që janë të sigurt dhe në gjendje të mirë pune si dhe vozitësit të kenë lejen e vozitjes në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 3) Të gjitha automjetet duhet të jenë të pajisura me ulëse për fëmijë dhe/ ose përforcues të përshtatshëm për moshën, në varësi të moshës dhe madhësisë së fëmijës. Përdorimi i rripave të sigurimit duhet të respektohet nga të gjithë pasagjerët sipas legjislacionit në fuqi, duke siguruar që fëmijët të mbahen siç duhet. Të gjitha automjetet duhet të jenë të pajisura me një çantë të ndihmës së parë dhe certifikatën e ndihmës së parë.
- 4) Institucioni duhet të sigurojë që çdo person i punësuar për transport, përfshirë vozitësit dhe shoqëruesit, të jetë i përshtatshëm për këtë rol dhe të ketë vërtetim të gjykatës se nuk ka qenë i dënuar për vepra penale më herët.

5) Përpara se të fillojnë mësimin në IEFH, prindërit dhe fëmijët do të njihen me sistemin e transportit, rrugët, vozitësit dhe shoqëruesit.

6) Ofruesit e transportit duhet të kenë qasje në një numër kontaktues të prindit/kujdestarit ligjor për urgjenca për secilin fëmijë.

Institucioni parashkollor përkatës siguron që transporti i kontraktuar iu përmbahet rregullave dhe ofron një mjedis të sigurtë të përshtatshëm për fëmijë.

Shuma e kuponit për IEFH-të do të caktohet varësisht nga komuna përkatëse dhe distanca rrugore.

Institucioni parashkollor mban regjistrin me deklaratat e nënshkruara nga prindërit me të cilat lejohen transportimi i fëmijës në IEFH.

Prindërit mund të japin komente për cilësinë dhe shumën e transportit dhe të adresojnë çdo shqetësim pranë institucionit parashkollor përkatës dhe përmes adresës elektronike të dedikuar për Programin tek MASHTI: ankesa.kuponat@rks-gov.net. MASHTI dhe IEFH do të sigurojë që shqetësimet do të adresohen brenda një afati deri në 15 ditë.

Në rastet kur Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe/ose MPV gjejnë parregullsi në ofrimin e transportit, atëherë IEFH-së i jepet një afat deri në 15 ditë për t'i adresuar shqetësimet përkatëse. Nëse edhe pas kalimit të këtij afati, DKA-të dhe/ose MPV gjejnë se shqetësimi ende nuk është adresuar, atëherë IEFH-së i ndërpritet kuponi i transportit.

Në rastet kur IEFH nuk ofron transport ose institucionit iu është ndërprerë kuponi i transportit, atëherë prindërve dhe kujdestarëve ligjorë ju ofrohet mundësia që ta përfitojnë direkt kuponin e transportit. Prindi apo kujdestari ligjor do ti dërgojnë të dhënat e tyre në MASHTI nëpërmjet adresës elektronike për përfitim të kuponit.

Shuma e kuponit për prindër/kujdestar ligjor do të caktohet varësisht nga vendbanimi, distanca rrugore dhe mjetet e disponueshme të transportit në komunën përkatëse.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, familjet të cilat përfitojnë nga SAS janë të liruar nga pagesa e transportit publik. Andaj, në komunat ku ofrohet transport publik dhe falas për përfituesit nga SAS, prindërit/kujdestarët ligjor nuk mund të përfitojnë nga kuponi i transportit.

6. Mekanizmi i ankesës

6.1 Mekanizmi i ankesës lidhur me vendimin për përfitim

Të gjitha ankesat në lidhje me vendimin për përfitimin nga Programi i Kuponave i drejtohen Komisionit të Ankesave pranë MASHTI-t.

Ankesa, së bashku me çdo dokument përkatës apo shtojcë, duhet të dorëzohet me shkrim në formë elektronike përmes platformës e-Kosova (Shtojca 5a). Parashtrimet duhet të bëhen jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së vendimit fillestar.

Pas dorëzimit, sistemi automatikisht do t'i dërgojë një mesazh konfirmimi ankuesit. Ky mesazh do të përfshijë afatin kohor për shqyrtimin e ankesës dhe një numër specifik referues. Ky numër referues mundëson gjurmimin e progresit të ankesës dhe ankuesit në një përgjigje të detajuar.

Komisioni i Ankesave ka për detyrë të kryej një shqyrtim të plotë të të gjitha ankesave të pranuar. Ai është i mandatuar t'i komunikojë me shkrim aplikantit vendimin e tij nëpërmjet e-Kosova brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të ankesës.

Komisioni i Ankesave shqyrton dokumentacionin, konsulton specialistët përkatës dhe mund të kërkojë informacion shtesë sipas nevojës. Në rastet që përfshijnë raste komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet për 15 ditë shtesë.

6.2 Mekanizmi i ankesës ndaj IEFH-ve

Pasi të fillojë Programi, prindërit dhe individë të tjerë të interesuar, në çdo kohë, mund të paraqesin ankesa në lidhje me transportin ose çdo aspekt të punës dhe trajtimit të IEFH-ve. Ankesat duhet të plotësohen duke përdorur formularin e ankesës të publikuar në faqen e internetit të MASHTI-t (Shtojca 5b), i ofruar në të gjitha gjuhët zyrtare. MASHTI do ta dorëzoj formularin edhe në kopje fizike në Qendrat për Punë Sociale (QPS), që të jetë i disponueshëm për përfituesit. Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: ankesa.kuponat@rks-gov.net.

Për të siguruar trajtimin e duhur të ankesës, të gjitha pjesët e formularit duhet të plotësohen saktë dhe tërësisht. Ankuesit kanë të drejtë të mbeten anonim dhe të dhënat e ankuesve do të trajtohen me kujdes si dhe do të mbahen konfidenciale.

Pas pranimit, të gjitha ankesat do të shqyrtohen me kujdes dhe do të regjistrohen në Regjistrin e Ankesave (Shtojca 5.c).

Pas dorëzimit, ankuesi do të pranojë automatikisht një email konfirmimi, duke përfshirë përgjigjet në Pyetjet më të Shpeshta (PSH) në lidhje me programin. Nëse çështja nuk adresohet në PSH, ankuesit do t'i kërkojë të sigurojë informacione ose prova shtesë në lidhje me ankesën e tyre.

Ankesat do të zgjidhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në rastet që përfshijnë çështje komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.

6.3 Mekanizmi i ankesave kundër aktiviteteve të Programit

Individët, grupet dhe komunitetet e tjera që besojnë se janë ndikuar negativisht nga Programi mund të paraqesin ankesë. Për të paraqitur një ankesë:

- a) Ankesa duhet të lidhet me aktivitetet e Programit.
- b) Ankesa duhet të përfshijë detaje të mjaftueshme për të demonstruar se një veprim ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë, duke ndikuar në mirëqenien individuale ose kolektive dhe që përfaqëson një rrezik të mundshëm social ose mjedisor.

Për të paraqitur një ankesë, ankuesit duhet të plotësojnë formularin e publikuar në faqen e internetit të MASHTI (Shtojca 4b), të ofruar në të gjitha gjuhët zyrtare. MASHTI do ta dorëzoj formularin edhe në kopje fizike në QPS, që të jetë i disponueshëm për përfituesit. Pasi të plotësohet, formulari duhet të dërgohet në emailin zyrtar të ankesave: ankesa.kuponat@rks-gov.net. Për të siguruar trajtimin e duhur të ankesës, të gjitha pjesët e formularit duhet të plotësohen saktë dhe tërësisht. Ankuesit kanë të drejtë të mbeten anonim dhe të dhënat e tyre do të mbahen konfidenciale dhe do të trajtohen me kujdes.

Pas dorëzimit, ankuesi do të pranojë automatikisht një email konfirmimi, duke përfshirë përgjigjet në pyetjet më të shpeshta (PSH) në lidhje me programin. Nëse çështja nuk adresohet në PSH, ankuesit do t'i kërkohet të sigurojë informacione ose prova shtesë në lidhje me ankesën e tyre.

Ankesat do të zgjidhen brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Në rastet që përfshijnë çështje komplekse ose ato që kërkojnë verifikim shtesë, procesi i vendimit mund të zgjatet edhe për 15 ditë të tjera.

Për të adresuar ankesat që dalin kundër IEFH-ve dhe ankesat kundër aktiviteteve të programit, MASHTI do të krijojë një ekip të specializuar që përbëhet nga Koordinatori i Programit, eksperti/ja social/e dhe staf shtesë sipas nevojës për të adresuar fushën specifike të shqetësimit (p.sh., teknologji e informacionit, financat, prokurimi, komunikimi, kushtet e punës, etj.). Koordinatori i Programit do të sigurojë përditësime të rregullta për ankuesin gjatë procesit të shqyrtimit për t'u siguruar që ata janë të informuar për statusin e ankesës së tyre.

MASHTI do të informojë palët e interesuara për mekanizmin e ankesave gjatë fushatës së ndërgjegjësimit publik dhe planit të komunikimit. Gjithashtu, informacioni për mekanizmin e ankesave do të promovohet nga MASHTI përmes një fletushke, në mënyrë që përfituesit e programit dhe palët e interesuara të informohen për procesin e ankesave dhe të drejtat e tyre, si dhe hapat që duhet të ndërmarrin për të bërë ankesë.

Pyetjet në lidhje me procesin e aplikimit dhe çështjet teknike me aplikimin mund të dërgohen në çdo kohë me email: programiikuponave@rks-gov.net dhe numrin e telefonit: 038 200 65048.

Këto ankesa do të trajtohen nga MASHTI përmes Koordinatorit të Programit në mënyrë të vazhdueshme, jo më vonë se deri në 3 ditë.

7. Shuma e rimbursimit të kuponave

Shuma e kuponëve e cila do të rimbursohet për fëmijë do të jetë deri në maksimum 150 euro për fëmijë dhe do të dalloj varësisht nga komuna përkatëse.

Llogaritja e shumës për komunë do të bëhet çdo vit nga MASHTI bazuar në mesataren e çmimeve të raportuara për komunë nga IEFH-të gjatë procedurës së licensimit. Rimbursimi nuk mund të kaloj shumën prej 150 euro për fëmijë.

8. Kontrollimi i pagesave, raportimi dhe auditimi

MASHTI, përmes Departamentit të Buxhetit dhe Financave do ti menaxhoj financat e Programit të Kuponave. Programi i Kuponave do të bazohet në sistemet e Menaxhimit Financiar Publik (MFP) të Kosovës, duke përfshirë hierarkinë e saj organizative, klasifikimin e buxhetit me kod të veçantë, strukturën e programit, raportimin dhe sistemet e monitorimit të shpenzimeve, funksionet e thesarit, kornizën e kontrollit të brendshëm dhe proceset e auditimit.

MASHTI do të ndjekë udhëzimet e Manualit të Operacionit të Projektit (MOP) për menaxhimin financiar, disbursimin, politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm.

MASHTI do ta dërgoj planin vjetor të buxhetit në MFPT për kërkesën e fondeve për Programin e Kuponave.

8.1 Kontrollimi i pagesave

Transaksionet do të kryhen bazuar në procedurat e thesarit, në llogaritë bankare të IEFH-ve.

MASHTI do të transferojë pagesat për shërbimet e edukimit të fëmijërisë së hershme dhe transportit në bazë të a) listës së institucioneve që janë pjesë e Programit të Kuponave, b) listës së fëmijëve përfitues, c) raporteve mujore, dhe d) në bazë të kërkesës për rimbursimin e transportit.

Pagesat do të përputhen me numrin e fëmijëve që përfitojnë nga Programi dhe do të bëhen në fund të çdo muaji. Verifikimi i numrit të fëmijëve përfitues dhe kërkesa për pagesë të institucioneve pjesëmarrëse do të bëhet në baza mujore nga Specialisti/ja i/e Menaxhimit Financiar (SMF) dhe do të dorëzohet në Divizionin për Buxhet dhe Financa të MASHTI-t.

Dokumentet të cilat duhet të bashkangjiten në kërkesën për pagesë përfshijnë:

- a) Lista e Institucioneve të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme e rigjeneruar nëpërmjet e-Kosova dhe e cila përfshinë;
 - Llogaritë bankare të institucioneve;
 - Numri i fëmijëve përfitues;

- Emri dhe mbiemri i fëmijës përfitues;
- Numri i fëmijëve që marrin shërbim të transportit;
- Emri dhe mbiemri i fëmijës që merr shërbimin e transportit nëpërmjet institucionit.

b) Lista e fëmijëve të cilët nuk e kanë vijuar edukimin për më shumë se 2 javë pa ndonjë arsye, e rigjeneruar nëpërmjet e-Kosova dhe vendimi i komisionit për ndërprerje të përfitimit nga programi;

- Kjo listë shërben për largimin e përfituesve të cilët nuk ndjekin edukimin nga lista e muajit të ardhshëm në mënyrë automatike.
- Vendimi i MASHTI-t për ndalimin e mbështetjes si rezultat i verifikimit të gjendjes faktike lidhur me mungesën pa arsye për më shumë se 2 javë.

c) Thesari i jep informacion Divizionit për Buxhet dhe Financa të MASHTI-t për çdo ekzekutim të pasuksesshëm të pagesës.

d) Bazuar në arsyetimin e pagesës së pasuksesshme, SMF nëpërmjet Koordinatorit të Projektit kontakton me institucionin përkatës për çdo përditësim të të dhënave në regjistrim.

e) Në rastet kur prindi/kujdestari ligjor përfiton direkt kuponin e transportit atëherë pagesa bëhet direkt në llogarinë bankare të prindit/kujdestarit ligjor pas verifikimit të vijueshmërisë së fëmijës në IEFH nga Koordinatori i Programit. MASHTI kërkon nga prindi dërgimin e dokumentit shtesë për ekzekutimin e pagesës;

- Konfirmimin e llogarisë bankare.

Disbursimet në kuadër të programit do të kryhen në përputhje me Udhëzimet e Disbursimit të Bankës Botërore. Shpenzimet e pranueshme për Programin e Kuponave do të rimbursohen me dëshmi të arritjes së KBP.

8.2 Raportimi

MASHTI do të mbajë regjistrat financiarë të projektit sipas skemës kontabël të Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) të identifikuar me kodin unik të projektit. SMF do të mbajë të dhënat financiare të monitorimit në formë të tabelave, të cilat do të kontrollohen periodikisht me SIMFK. Raportet e ndërmjetme financiare të pa audituara do t'i dorëzohen Bankës në baza tremujore brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori. SMF do të jetë përgjegjës për përgatitjen e raporteve periodike të projektit dhe pasqyrave financiare vjetore bazuar në informacionet e pranuar nga:

- Regjistrimet financiare në SIMFK;
- Raportet e pranuar nga MPV dhe DKA-të lidhur me pjesëmarrjen e përfituesve në institucionet e edukimit në fëmijërinë e hershme;

- Raportet mujore të institucioneve pjesëmarrëse të dorëzuara nëpërmjet e-Kosova.

Koordinatori i Programit të Kuponave së bashku me SMF do të mbajnë të dhëna të vazhdueshme lidhur me raportet e pranura nga mekanizmat verifikues dhe monitorues. Pasqyra vjetore financiare do të përgatitet në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik.

Periodha e parë e raportimeve do të përcaktohet nga koha kur do të fillojnë pagesat për shpenzimet e pranueshme.

8.3 Auditimi

Procesi i auditimit të Programit të Kuponave do të jetë pjesë e auditimit të përgjithshëm të projektit “*Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës*” dhe do të kryhet nga auditorët e brendshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, dhe auditimi i jashtëm sipas kushteve të referencës të pranueshme për BB. Në rast se Zyra Kombëtare e Auditimit do të tërhiqet nga angazhimi, auditimet e pasqyrave financiare të projektit do të kryhen nga auditorë privatë të pranueshëm për BB dhe tarifat e auditimit do të financohen nga burimet e projektit.

Pasqyra vjetore Financiare e Projektit (PFS) e audituar së bashku me letrën e menaxhmentit, do t'i dorëzohet BB jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal (kalendarik).

9. Monitorimi i Programit të Kuponave

9.1 Mekanizmi i Pavarur për Verifikim (MPV)

Programi i Kuponave do të mbështesë një Mekanizëm të Pavarur Verifikimi (MPV) për të verifikuar arritjen e objektivave vjetore të KBP-së dhe për të konfirmuar shpërndarjen e kuponëve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në përputhje me Udhëzuesin. MPV do të zgjidhet nga MASHTI përmes përzgjedhjes konkurruese sipas rregulloreve dhe procedurave të prokurimit të projekteve të pranueshme nga BB.

MPV do të zgjidhet për të përmbushur detyrat si: (a) mbledhja dhe analiza e të dhënave, (b) vlerësimi i ndikimit të programit dhe (c) monitorimi i treguesve kyç. Mekanizmi do t'i dorëzojë MASHTI-t raporte të rregullta tremujore dhe një raport përmbledhës vjetor.

Procedurat e verifikimit do të përfshijnë:

- Shqyrtimin dhe analizën e raporteve, dokumentacionit të regjistrimit të fëmijës në institucion, dhe provave, verifikimin e një kampioni të rastësishëm përfaqësues të familjeve përfituese, vizitat në terren dhe kontrollet, konfirmimin e shpërndarjes së kuponëve dhe pjesëmarrjen e fëmijëve (të paktën 10 për qind e familjeve përfituese).
- Verifikimin e përshtatshmërisë së ofruesve të shërbimeve në raport me ligjin në fuqi, regjistrimin dhe vijueshmërinë e fëmijëve për të paktën gjashtë muaj pa ndërprerje si kusht i KBP-së, përshtatshmërinë e transportit të ofruar dhe përshtatshmërinë e tyre sipas SAS.

- MASHTI do të raportojë në bazë të informatave të pranuara nga raportet e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme (me progresin mujor të zhvillimit të fëmijëve dhe kontrollet në vend nga autoritetet relevante) dhe do ta ndajë raportin me MPV dhe BB.
- MPV përgatit raportin e verifikimit në fund të vitit akademik dhe e shpërndan për shqyrtim tek MASHTI dhe BB.

Treguesit bazë që do të monitorohen përfshijnë: 1) përqindja (%) e rritjes së përfituesve në krahësim me numrin fillestar, 2) përqindja (%) e fëmijëve të regjistruar përmes Programit të Kuponave dhe të cilët kanë vazhduar edukimin për më shumë se 6 muaj, 3) përqindja (%) e prindërve që tregojnë se janë të kënaqur me Programin e Kuponit, 4) përqindja (%) e IEFH pjesëmarrëse në Programin e Kuponave, dhe 5) përqindja (%) e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfituese.

9.2 Drejtoritë Komunale për Arsim (DKA)

Zbatimi i Programit të Kuponave do të monitorohet dhe përfituesit do të verifikohen nga DKA-të sipas mandatit dhe juridiksionit të tyre.

Pas përzgjedhjes së përfituesve, MASHTI do t'i komunikoj të dhënat e IEFH dhe informatat e përfituesve me DKA-të, me qëllim të lehtësimit të procesit të verifikimit. Bazuar në listat e pranuara nga MASHTI, DKA-të do t'i realizojnë vizitat e para verifikuese duke filluar nga java e dytë, ndërsa vizitat e vazhdueshme do të realizohen një herë në muaj në secilin institucion ku janë të regjistruar përfituesit. MASHTI do ta ndajë formularin e raportimit (Shtojca 6), me DKA-të. Verifikimit do ti nënshtrohen treguesit përfshirë:

- Verifikimi i regjistrimit fillestar të fëmijëve përfitues brenda 2 javëve të para të përzgjedhjes në bazë të listës së përcjellë nga MASHTI;
- Verifikimi i identitetit të fëmijëve me listën e përcjellë nga MASHTI;
- Verifikimi i dokumentacionit regjistruar të fëmijës në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Kontrollimi i vijueshmërisë së përfituesve dhe kontrollimi i raporteve të mungesës (me bazë mujore).
- Kontrollimi i dokumentacionit dhe përshtatshmërisë së transportit në raport me kriteret e vendosura, kur ofrohet nga institucioni.

Për të gjitha vizitat monitoruese hartohet raporti në të cilin konstatohet gjendja faktike, i cili dërgohet tek Koordinatori i Programit të Kuponave në MASHTI, në javën e fundit të muajit.

Në rastet kur DKA gjen parregullsi në ofrimin e transportit atëherë i jep IEFH-së një afat kohor deri në dy javë për të adresuar shqetësimin përkatës. Nëse, edhe pas kalimit të kësaj kohe në vizitën e ardhshme, DKA gjen se shqetësimi ende nuk është adresuar, i rekomandon MASHTI-t ndërprerjen e kuponit të transportit.

10. Përfundimi i ciklit të edukimit nga fëmijët

Fëmijët që regjistrohen në Programin e Kuponave kanë të drejtë të përfitojnë nga programi deri pas moshës pesë vjeçare kur kalojnë në sistemin parafillor publik të detyrueshëm, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme.

Fëmija i cili pranohet në program nuk ka nevojë të aplikoj çdo vit por vetëm rikonfirmon të dhënat dhe dokumentet e mëhershme në procedurën e riaplikimit nëpërmjet e-Kosova (Shtojca 7) dhe regjistrohet në IEFH-në pjesëmarrëse.

Çdo vit, varësisht nga numri i fëmijëve që përfitojnë nga programi, MASHTI do të bëjë rivlerësimin e buxhetit të grantit, do të përshtatë kriterin e moshës së fëmijëve dhe do të hap thirrjen për aplikimin e përfituesve potencial.

Në qoftë se familja pushon së qeni përfituese e SAS, fëmijës i ndërpritet pjesëmarrja në Programin e Kuponave.

11. Plani i komunikimit

MASHTI do të informojë familjet e përzgjedhura, zyrtarët pranë Qendrave për Punë Sociale (QPS) dhe IEFH-të në lidhje me Programin e Kuponëve përmes takimeve informuese, angazhimit në media dhe përditësimeve të vazhdueshme nëpërmjet platformave dixhitale dhe kanaleve zyrtare.

MASHTI do të bashkëpunojë ngushtë me Departamentin përkatës për Skema Sociale pranë MFPT-së dhe me QPS-të. Çdo vit para hapjes së aplikimit për familje, MASHTI do të organizojë të paktën një sesion informues për çdo regjion të Kosovës me zyrtarët e QPS-ve nga komunat pjesëmarrëse. Këto takime do të informojnë zyrtarët për objektivat e programit, kriteret e përzgjedhjes dhe përfitimet, duke i pajisur ata që t'ua komunikojnë këtë informacion në mënyrë sa më efektive përfituesve të mundshëm.

MASHTI do të hartojë një fletushkë informative të qasshme në lidhje me Programin e Kuponave, ku do të përshkruhen objektivat, kriteret e përputhshmërisë dhe përfitimet e tij. Fletushka do të ofrojë gjithashtu detajet e kontaktit të mekanizmit të ankesave të këtij programi. Kjo fletushkë do të vendoset në hyrje të QPS-ve në të gjitha komunat pjesëmarrëse për të siguruar dukshmëri për familjet e interesuara.

Para hapjes së aplikimit, MASHTI do të kontaktojë të gjitha IEFH-të e licensuara përmes emailit për t'i informuar rreth Programit si dhe do të mbajë të paktën një takim në secilin regjion të Kosovës me përfaqësues të institucioneve parashkollë të licensuara për të siguruar që ata janë të informuar rreth Programit të Kuponave, funksionimit të tij dhe hapat e nevojshëm për pjesëmarrjen e tyre. Kjo do të përfshijë edhe përgjegjësitë e institucioneve në raportim dhe monitorim.

MASHTI do të mbajë të paktën një trajnim përgatitor informues me të gjitha IEFH-të që janë përzgjedhur si pjesë e Programit për t'i informuar ato për detyrat e tyre në kuadër të Programit dhe Udhëzuesin e Programit.

Çdo vit, pas mbylljes së aplikimit, MASHTI do të kontaktojë DKA-të përmes emailit për t'i informuar rreth Programit si dhe do të mbajë të paktën një takim në secilin region të Kosovës me përfaqësues të tyre për të siguruar që ata janë të informuar rreth Programit të Kuponave, funksionimit të tij dhe rreth përgjegjësi të tyre në raport me monitorimin e Programit. Trajnimi duhet të kryhet gjithashtu për kodin e sjelljes dhe mekanizmin e ankesave dhe komenteve.

Programi i Kuponit do të promovohet përmes të gjitha kanaleve zyrtare të komunikimit të MASHTI-t, duke përfshirë platformat e mediave sociale, faqen e internetit të MASHTI-t dhe emailin, në të gjitha gjuhët zyrtare. Postimet do të përfshijnë thirrje të qarta për veprim për familjet potenciale për të aplikuar, si dhe pyetjet më të shpeshta dhe përditësime mbi pikat kryesore të programit.

MASHTI do të prezantojë Programin e Kuponave në platformat mediale në Kosovë, duke përfshirë televizionin, radion dhe platformat online. Këto angazhime mediatike do të nxjerrin në pah përfitimet e programit dhe hapat që familjet duhet të ndërmarrin për të marrë pjesë.

Rezultatet dhe sukseset e Programit të Kuponave do të promovohen rregullisht në të gjitha kanalet mediatike të MASHTI-t. Përditësimet do të përfshijnë pikat kryesore, të tilla si numri i fëmijëve që përfitojnë nga programi dhe ndikimi në komunitetet pjesëmarrëse. Të gjitha postimet që përfshijnë fëmijë do të respektojnë privatësinë e tyre, në përputhje me nenet 39 dhe 45 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

MASHTI do të krijojë një adresë elektronike të dedikuar: programiikuponave@rks-gov.net dhe një numër telefon: 038 200 65048, ku familjet, palët e interesit dhe institucionet mund të bëjnë pyetje ose të japin komente për Programin e Kuponave dhe do të komunikohet përmes kanaleve zyrtare të MASHTI-t.

12. Faza e pilotimit

Faza pilotuese e programit do të përfshij kohën e nevojshme për procesin e aplikimit dhe përzgjedhjen e përfituesve nga komisioni, pasuar nga një periudhë gjashtëmujore gjatë së cilës fëmijët do të vijojnë edukimin në IEFH. Pilotimi do të zbatohet në katër komuna të zgjedhura bazuar në një kombinim faktorësh si numri i IEFH-ve në dispozicion, numri i fëmijëve në SAS dhe disponueshmëria e opsioneve të transportit.

Komunat e përzgjedhura për pilotim janë:

- Komuna e Prishtinës;
- Komuna e Prizrenit;

- Komuna e Gjilanit;
- Komuna e Lipjanit.

Numri i kuponëve i cili do të shpërndahej në fazën e pilotimit do të jetë 100 kupona për 100 fëmijë.

Shuma e kuponit për komunat e pilotimit do të jetë:

Komuna	Shuma e cila rimbursohet nga programi
Prishtinë	150 Euro
Prizren	100 Euro
Gjilan	90 Euro
Lipjan	100 Euro

Në të gjitha komunat, programi do t'i rimbursojë IEFH-të për koston e transportit në formë të kuponave në shumën prej 50 euro deri në 80 euro për fëmijë. Ndërsa, prindërit dhe kujdestarët ligjorë do të rimbursohen për koston e transportit në shumën prej 60 euro deri 100 euro për fëmijë.

Gjatë fazës së pilotimit, në qoftë se familja pushon së qeni përfituese e SAS, fëmijës nuk i ndërpritet pjesëmarrja në Programin e Kuponave.

Pas përfundimit të pilotimit, MASHTI do të kryejë një vlerësim për të mbledhur njohuri nga mësimet e nxjerra dhe për të adresuar çdo sfidë të hasur. Ky vlerësim do të informojë pjesën e mbetur të programit, duke përfshirë për ndryshimet e nevojshme në këtë Udhëzues për të siguruar mbarëvajtjen efektive të programit.

Shtojcat

Shtojca 1. Regjistrimi i Institucioneve Parashkollore Private për Programin e Kuponave përmes e-Kosova

Opsioni duhet të jetë i hapur për të gjitha IEFH private të cilat posedojnë licensë nga MASHTI dhe janë biznese të regjistruara në ARBK.

Opsioni duhet të hapet një herë në vit për përditësim të dhënave dhe për regjistrim të IEFH-ve të reja.

Informatat që duhet ti përmbaj vegëza:

- Emri i institucionit;
- Adresa e institucionit;
- Numri i llogarisë bankare biznesit;
- Të dhënat e ARBK;
- Numri i vendeve të disponueshme për pranimin e fëmijëve (me mundësi përditësimi);
- Numri i vendeve të disponueshme për pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (me mundësi përditësimi);
- Opsioni nëse ata mund të ofrojnë transport për fëmijën. (po, jo);

Nëse po, atëherë shfaqet një ikonë me kriteret të cilat IEFH duhet të përmbush për transport të listuara në pjesën 5 të Udhëzuesit:

Kriteret për ofrimin e transportit nga IEFH:

1) Forma e transportit duhet t'i mundësojnë fëmijës të udhëtojë me siguri dhe rehati të arsyeshme, si dhe një shoqërues/e e rritur duhet t'i shoqërojë fëmijët në çdo udhëtim. Ky person do të jetë përgjegjës për t'u siguruar që fëmijët të ulen siç duhet, të mbikëqyrë sjelljen e tyre dhe t'i ndihmojë ata gjatë hyrjes dhe daljes. Prindërit gjithashtu mund ta shoqërojnë fëmijën e tyre në udhëtimet e para derisa fëmija të ndihet rehat. Si një udhëzues i përgjithshëm, koha maksimale e udhëtimit për fëmijën nuk duhet të kalojë 30 minuta në çdo drejtim.

2) Të gjitha automjetet duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të rregullta teknike për t'u siguruar që janë të sigurta dhe në gjendje të mirë pune si dhe vozitësit të kenë lejen e vozitjes në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3) Të gjitha automjetet duhet të jenë të pajisura me ulëse për fëmijë ose përforcues të përshtatshëm për moshën, në varësi të moshës dhe madhësisë së fëmijës. Përdorimi i rripave të sigurimit duhet të respektohet nga të gjithë pasagjerët sipas legjislacionit në fuqi, duke siguruar që fëmijët të mbahen siç duhet. Të gjitha automjetet duhet të jenë të pajisura me një çantë të ndihmës së parë dhe certifikatën e ndihmës së parë.

4) Institucioni duhet të sigurojë që çdo person i punësuar për transport, përfshirë vozitësit dhe shoqëruesit, të jetë i përshtatshëm për këtë rol dhe të ketë vërtetim të gjykatës se nuk ka qenë i dënuar për vepra penale më herët.

5) Përpara se të fillojnë mësimin në IEFH, prindërit dhe fëmijët do të njihen me sistemin e transportit, rrugët, vozitësit dhe shoqëruesit.

6) Ofruesit e transportit duhet të kenë qasje në një numër kontaktues të prindit/kujdestarit ligjor për urgjenca për secilin fëmijë.

Programi i Kuponave do të rimbursojë institucionin parashkollor për koston e transportit në formë të kuponave në bazë të kriterëve të përcaktuara në pjesën 5 të Udhëzuesit.

Aplikuesi selekton me tik se:

X Institucioni i edukimit në fëmijërinë e hershme deklaron se ka lexuar me kujdes dhe se përmbush kriteret e përcaktuara me pjesën 5 të Udhëzuesit për përfitimin e Kuponit të Transportit.

Shtojca 2. Raportimi i IEFH Private për vijueshmërinë e përfituesve përmes e-Kosova (duhet të jetë i hapur gjithnjë dhe të dhënat të ruhen në formë të databazës).

- Emri Mbiemri i fëmijës (duhet ta përditësoj IEFH)
- A ka munguar fëmija në 2 javët e fundit pa ndonjë paralajmërim/arsyetim paraprak?
- A ka ndjekur fëmija mësimin në këtë muaj?

Sistemi duhet ti ndaj të dhënat me MASHTI-n në baza mujore. Ky opsion duhet të jetë me mundësi shtimi për arsye se në një kopsht mund të jenë dy e më shumë fëmijë përfitues të programit.

Shtojca 3. Aplikimi i familjeve për përfitim nga Programi i Kuponave – i hapur për të gjithë familjet të cilët kanë fëmijë të moshës 2 vjet e 6 muaj deri në 4 vjet e 6 muaj dhe që janë përfituese nga Skema e Asistencës Sociale, përmes e-Kosova

- Emri Mbiemri i prindërve ose kujdestarit;
- Adresa e saktë (emri i lagjes, numri i derës);
- Regjioni (të rigjenerohet automatikisht);
- Numri i kontaktit;
- Numri i fëmijëve për të cilët ata kërkojnë mbështetje nga Programi i Kuponit;
- Emri Mbiemri i fëmijës/fëmijëve (Mosha minimale e fëmijës duhet të jetë 2 vjeç e 6 muaj deri në 4 vjeç e 6 muaj më së shumti. Por, nuk përjashtohen edhe fëmijët të cilët janë mbi 2 vjeç e 6 muaj ose më pak se 4 vjeç e 6 muaj);
- Karta e ndihmës sociale (të ngarkohet si dokument);
- Nëse është me kujdestar ligjorë (të konfirmohet me tik/opsion) dhe duhet të ngarkohet dëshmia për kujdestarinë ligjore;
- Dëshmia e vaksinimit, pasaporta e vaksinimit të fëmijëve (të ngarkohet si dokument);

- Përzgjedhja e një institucioni që ofron shërbime të edukimit të fëmijërisë së hershme brenda komunës së aplikantit. (informata e adresës së institucionit të ndahet në këtë opsion);
- A është fëmija juaj me aftësi të kufizuar ? (opsioni 1.po, jo, nëse opsioni 1.është po, atëherë shfaqet ngarko dokumentin);
- Sa larg është distanca nga vendbanimi juaj në kopshtin e përzgjedhur ? (më pak se 4 km më shumë se 4 km);
- Përafërsisht sa km larg? (Nëse zgjidhet opsioni më shumë se 4 km, atëherë del ky opsion ku nga aplikuesi pritët të shënojë numrin e kilometrave)
- Opsioni nëse ata kërkojnë transport nga kopshti ? (nëse kopshti i regjistruar ka deklaruar se ofron transport, dhe nëse familja ka selektuar se është më larg se 4 km) (po ose jo)
- Opsioni nëse familja apo kujdestari ligjor kërkon të ju mbulohet transporti në formë të pagesës ? (nëse kopshti të cilin ata përzgjedhin nuk ofron transport dhe familja ka selektuar se distanca është më larg se 4 km atëherë shfaqet ky opsion) (po, ose jo) nëse po, atëherë: kërkohet: Numri i llogarisë bankare të aplikuesit.

Aplikuesi selekton me tik se:

X Deklaroj se të dhënat e ofruara janë të sakta, janë dhënë me vullnet të lirë dhe jap pëlqimin që ato të përdoren nga MASHTI për përmbushjen e aktiviteteve të Programit të Kuponave, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Verifikimit automatik do ti nënshtrohen;

- Certifikata familjare;
- Certifikata e lindjes së fëmijëve;
- Numri i llogarisë bankare;

Sistemi duhet ti ndaj të dhënat e verifikuara me MASHTI.

Shtojca 4. Dokumenti i Kuponit

Njoftimi 4a. Vendimi i Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponave u dërgohet të gjithë aplikuesëve në e-Kosova.

Njoftimi 4b. Aplikantët të cilët përzgjidhen për të qenë pjesë e Programit të Kuponave u shkon ky Dokument i Kuponit si konfirmim dhe të ekzistoj mundësia të ruhet në sistem si dhe të shkarkohet si dokument pdf.

Dokument i Kuponit

Numri i referencës i gjeneruar automatikisht gjatë aplikimit:

I/E nderuar,

Fëmija juaj është përzgjedhur për të qenë pjesë e Programit të Kuponave i cili zbatohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Programi ka për qëllim të përmirësoj qasjen në institucionet parashkollore për fëmijët 3-5 vjeç, familjet e të cilëve janë të regjistruara në Skemën e Asistencës Sociale.

Ju lusim që brenda 5 ditëve të punës të paraqiteni në institucionin parashkollor të përzgjedhur për të regjistruar fëmijën tuaj si dhe për të konfirmuar:

- të dhënat e imunizimit/vaksinimit, alergjitë ose nevoja të veçanta ushqimore dhe shëndetësore, përfshirë edhe dëshminë nga mjeku për gjendjen e përgjithshme të fëmijës;
- informacionin e kontaktit të prindit/kujdestarit; dhe
- transportin e ofruar nga institucioni (nëse aplikohet).

Si përfitues keni për detyrë dhe përgjegjësi:

- Të dërgoni me rregull fëmijën në institucionin parashkollor derisa fëmija të regjistrohet në edukimin parafillor të obligueshëm pas moshës 5 vjeçare;
- Të lajmëroni institucionin parashkollor në rast se fëmija mungon për shkaqe të arsyeshme;
- Të organizoni transportin për fëmijën tuaj (vlen vetëm nëse keni fituar kuponin e transportit direkt);
- Të përgjigjeni në vlerësimet e realizuara lidhur me ndikimin e Programit.

Si përfitues keni të drejtë:

- Të njoftoheni me institucionin parashkollor ku do të regjistrohet fëmija juaj, ambientin, mënyrën e funksionimit;
- Të njoftoheni dhe familjarizoheni me sistemin e transportit të ofruar nga institucioni parashkollor (vlen vetëm nëse keni fituar kuponin e transportit të organizuar nga institucioni);
- Të ankoheni për çfarëdo lloj parregullsie apo shqetësimi lidhur me Programin duke dorëzuar formularin e ankesës në adresën elektronike: ankesa.kuponat@rks-gov.net.

X Deklaroj se e kuptoj dhe pranoj kushtet e pjesëmarrjes në Programin e Kuponave.

Shtojca 5. Mekanizmi i ankesës dhe komenteve

Formulari 5.A Mekanizmi i ankesave përmes e-Kosova

(Kjo pjesë duhet të jetë gati pas përfundimit të vegëzës 1 dhe qasje në këtë vegëz duhet të kenë si institucioni parashkollor ashtu edhe familja/kujdestari ligjor aplikues/e)

1. Ju lutem tregoni natyrën e ankesës suaj *(duhet të mundësohet zgjedhja e disa opsioneve për ankim)*
 - 1.1 Komisioni i Vlerësimit nuk ka vlerësuar drejtë kriterin e moshës së fëmijës;
 - 1.2 Komisioni i Vlerësimit nuk ka vlerësuar drejtë kriterin e SAS;
 - 1.3 Përfitimi nuk është pranuar përkundër konfirmimit si përfitues;
 - 1.4 Tjetër.

(Pas përzgjedhjes së natyrës së ankesës, ankuesit i jepet mundësia të shënoj me shkrim deri në 500 fjalë më detajisht lidhur me ankesën)

2. A keni ndonjë ankesë ose informatë tjetër që nuk u përmend më lart? *(ju lutem specifikoni)*

(ankuesit i jepet mundësia të shënoj me shkrim deri në 250 fjalë)

Ankuesit i jepet mundësia që të bashkangjis çdo dokument që konsideron se e mbështet ankesën (attach).

Pas dorëzimit të ankesës, ankuesit i dërgohet përgjigje e gjeneruar në mënyrë automatike:

Faleminderit që na informuat për ankesën tuaj. Ne e konfirmojmë marrjen e ankesës tuaj me numrin referues: _____. Komisioni i Ankesave po vlerëson me kujdes ankesën tuaj dhe do të ju informoj nëse nevojitet ndonjë informacion shtesë si dhe vendimin lidhur me ankesën tuaj brenda 15 ditëve.

Formulari 5. B Ankesa në lidhje me IKFH-të dhe aktivitetet e programit

SHQIP

Formulari i ankesës

Programi i Kuponave

Numri i referencës (opsional)	
Emri dhe mbiemri (opsional)	
Numri i letërnjoftimit (opsional)	
Adresa (opsionale)	
Informacioni i kontaktit	A. Postë: Ju lutem shkruani adresën tuaj _____ _____
Ju lutemi tregoni se si dëshironi të kontaktoheni (postë, telefon, e-mail).	B. Telefon: _____ C. Email: _____

Gjuha e
preferuar e
komunikimit

- A. Shqip
- B. Serbisht
- C. Anglisht

Për çfarë është ankesa juaj?

Ju lutemi jepni detaje shtesë? Çfarë ka ndodhur? Ku ka ndodhur? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit?

A. Incident/ankesë një herë (data _____)

B. Ndodhi më shumë se një herë (sa herë? _____)

C. Në vazhdimësi (aktualisht po përjetoj të njëjtin problem)

Ju lutemi bashkëngjitni çdo dokument shtesë të kërkuar:

Çfarë do të dëshironit të shihnit si zgjidhje?

Dërgojeni në: ankesa.kuponat@rks-gov.net

SERBISHT

Formular za žalbu

Program vaučera

Referentni broj (opciono)	
Puno ime i prezime (opciono)	
Broj lične karte (opciono)	
Adresa (opciono)	
Kontakt informacije Molimo navedite kako želite da budete kontaktirani (pošta, telefon, e-mail).	A. Pošta: Molimo upišite vašu adresu: _____ _____ _____ B. Telefon: _____ C. E-mail: _____

Preferirani jezik
komunikacije

- A. Albanski
- B. Srpski
- C. Engleski

O čemu je vaša žalba?

Molimo vas navedite dodatne detalje: Šta se dogodilo? Gde se dogodilo? Kome se dogodilo?
Koji je ishod problema?

Incident/jednom žalba (datum _____)

B. Desilo se više puta (koliko puta? _____)

C. U kontinuitetu (trenutno doživljavam isti problem)

Molimo priložite sve dodatne potrebne dokumente:

Šta biste želeli kao rešenje problema?

Pošaljite na: ankesa.kuponat@rks-gov.net

Formulari 5. C Regjistri i Ankesave

N r .	Dat a e pra nim it të ank esë s	Më nyr a si ësh të pra nua r ank esa	Kat ego ria e ank esës (nd aj IEF H- së, akti vite tete ve të pro gra mit, tjetë r)	Për mbl edhj e e ank esës	Ano nime (po/j o)	Kate goria e anku esit (prin d, IEFH , tjetë palë e inter esit)	Pers oni përg jegjë s për adre simi n e anke sës	Sta tusi (i zgji dhu r, në prit je, refe rim i në prit je)	Dat a e zgji dhj es së ank esë s	Njo ftim i lidh ur me ven dim in
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										

Shtojca 6. Formulari i verifikimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit

1. Data e monitorimit;
2. Numri i referencës;
3. Qëllimi i vizitës;
4. Emri i institucionit të inspektuar;
5. Emri Mbiemri i fëmijës;
6. Moshë;
7. Gjinia;
8. Etniciteti;
9. Kontrollimi dhe verifikimi i dokumentacionit të regjistrimit të fëmijës në bazë të legjislacionit në fuqi;
10. Data e regjistrimit në institucion si përfitues i programit;
11. Kontrollimi i listës së vijueshmërisë së fëmijës;
12. Kontrollimi i raporteve të dorëzuara nga institucioni lidhur me mungesën e vijueshmërisë;
 - Listimi i numrit dhe muajit të raporteve të dorëzuara.
13. Kontrollimi i dokumenteve të arsyetimit të mungesës së fëmijës.
14. Kontrollimi i dokumentacionit dhe përshtatshmërisë së transportit kur ofrohet nga institucioni.

Shtojca 7. Riaplikimi për prindërit apo kujdestarët ligjorë për vazhdimin e kuponit përmes e-Kosova.

Ky opsion duhet të jetë i hapur vetëm për përfituesit paraprak të programit.

- Adresa e saktë, emri i lagjes, numri i derës e rigjeneruar nga aplikimi i kaluar (ky opsion duhet të jetë i ndryshueshëm në riaplikim);
- Regjioni (të rigjenerohet automatikisht);
- Numri i kontaktit (ky opsion duhet të jetë i ndryshueshëm në riaplikim);
- Emri Mbiemri i fëmijës/fëmijëve për të cilët riaplikohet (shfaqet automatikisht);
- Karta e ndihmës sociale (të ngarkohet si dokument).